



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

Numri i lëndës: 2019:088714  
Datë: 09.07.2024  
Numri i dokumentit: 05913558

PML.nr.397/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Nebojsha Boriqiç, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës në çështjen penale ndaj të akuzuarit E. S. nga P., për shkak të veprës penale Shtytje në kryerjen e veprës së rëndë nga neni 147 paragrafi 3 dhe 9 lidhur me nenin 24 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkritazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit së të akuzuarit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovë PN.nr.S.nr. 91/2024 të datës 17.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PN.II.nr.4/2024 të datës 27.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 01.07.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të akuzuarit E. S., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovë PN.nr.S.nr. 91/2024 të datës 17.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PN.II.nr.4/2024 të datës 27.05.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.170/2020 të datës 03.05.2024 të akuzuarit E. S., për shkak të veprës penale Shtytje në kryerjen e veprës së rëndë nga neni 147, paragrafi 3 dhe 9 lidhur me nenin 24 të KPRK, akuzuarit ia ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak me datën 03.05.2024 dhe e ka liruar të akuzuarin të mbrohet në liri, konform nenit 181 paragrafi 7 lidhur me nenin 190 të KPP-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin PN.1.S.nr.91/2024 të datës 17.05.2024 duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, pas aprovimit të saj e ka ndryshuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.170/2020 të datës 03.05.2024, ashtu që të pandehurit i ka caktuar masën e paraburgimit konform dispozitës së nenit 184 paragrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 e lidhur me nën-paragrafin 1.3 të KPP, e cila masë do ti zgjasë deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykim.

Në procedurën ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin PN.II DP. nr. 04/2024 të datës 27.05.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit E. S., dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së Apelit të Kosovës.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit E. S., avokat Besnik Berisha për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor (neni 432.1, nën-paragrafi 1.3 i KPP. Shkelje të së drejtës Kushtetuese për liri dhe siguri, të garantuar nga neni 29,1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës , interalia neni 5 i KEDNJ.

Zyra e Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.163/24 e datës 20.06.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës e në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi i të akuzuarit thekson se atvendimi i atakuar me kërkesë i Gjykata Supreme, përfshihet në shkelje esenciale nga neni 411 i KPP-së, me çka absorbon me automatizëm shkeljet e neneve 7,159,171.2,182.2, 184.1 dhe nenin 366.1 të KPP, për shkak se në tërësinë e arsytimit të aktvendimit, ka shpërfillur në tersi detyrimet që rrjedhin nga këto dispozita, me pasojë legjitimitetin e një ankese përmbajtja së cilës është e pa lejuar dhe e kundërligjshme. Gjykata Supreme e Kosovës edhe pse tërthorazi ka përmendur pretendimet e mbrojtjes, e njëjta ka dështuar plotësisht që ti shqyrtoj pretendimet ankimore, duke amnistuar edhe shkeljet e Gjykatës së Apelit në dëm të akuzuarit E. S., me pasojë edhe përtej saj, duke krijuar praktikë të kundërligjshme, sipas të cilave pas shpalljes së aktgjykimit me dënim mbi 5 vite duhet caktohet edhe paraburgimi edhe pse një normë e tillë është shfuqizuar në KPP.

Pastaj theksohet në kërkesë “*se konstatimi i Gjykatës Supreme se pretendimet ankimore të mbrojtësit janë të pa bazuara sepse ankesa nuk është e kundërligjshme, por ankesa është drejtë dhe e ligjshme (siç me të drejtë janë udhëzuar palët për të drejtën e ankesës në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë) si dhe kategori kushtetuese, po ashtu edhe gjykata e*

*shkallës së dytë, duke vepruar sipas ankesës ka të drejtë dhe kompetencë që konform gjetjeve të ndryshoj vendimin e gjykatës së shkallës së parë”, sipas mbrojtjes një konstatim i tillë nuk është në harmoni me pretendimet ankimore të mbrojtjes, pasi që përmes ankesës së mbrojtjes nuk është atakuar ankesa si mjet i pa lejuar procedural, por është atakuar papërshtatshmëria e ankesës me kërkesat imperative ligjore të cilat burojnë nga KPP, të cilat si të tilla determinojnë përmbajtjen e ankesës dhe rrjedhimisht lejueshmërinë e saj.*

Tutje theksohet se PSRK-ja nuk kishte parashtruar ankesën në përputhje me kapitullin XII të KPP, me që në ankesë mungojnë kërkesat ligjore nga neni 376.1 nën-paragrafi 1.5 dhe 1.6 të KPP-së, pasi që mjetit juridik i mungonte në tersi baza ligjore dhe se me ankesë nuk ishte goditur dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, por, përmes një mjete juridik të titulluar ankesë, përmes së cilës palët udhëzoheshin që ankesa mund të ushtrohej kundër aktvendimit që ndërkrete masën e arrestit shtëpiak, ndërsa PSRK-ja, nuk kishte goditur vendimin, por kishte arritur të kamufloj një kërkesë të re për caktimin e paraburgimit, e cila në tersi është e kundërligjshme, e pa lejuar dhe përbën precedent të rrezikshëm juridik, e cila i jep prokurorisë pushtet inkuizitor lidhur me caktimin e paraburgimit dhe atë në çdo fazë të procedurës penale, përfshirë edhe përmjet mjetit juridik, gjë që cenon në mënyrë të drejtpërdrejte vendimmarrjen e gjyqësorit, me pasojë shkeljen e nenit 29 dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës.

Në lidhshmëri me këtë mbrojtja thekson se Gjykata Supreme me vendimin e atakuar nuk ka bërë të qartë se cila është baza ligjore e cila i lejon prokurorisë mundësinë që përmes ankesës të parashtror kërkesë për caktimin e paraburgimit si rrethanë “*in peius*” për të akuzuarin Enver Sekiraqa.

Mbrojtja e të akuzuarit në kërkesë, po ashtu duke ju referuar nenit 415.2 të KPP, me respekt parashtron se shkelja e dispozitave si më lartë, të akuzuarit S., i shkakton dëm të pa riparueshëm pasi që aktvendimi i atakuar e detyron të qëndroj në paraburgim në masën e paraburgimit mbi një dekadë në pritje të aktgjykimit të formës së prerë.

Gjykata Supreme të Kosovës, vlerëson se pretendimet e mësipërme në kërkesë janë të pabazuara, sepse ashtu siç ka konstatauar gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ankesa është mjet i rregullt juridik, nuk është e kundërligjshme por është e drejtë dhe e ligjshme (siç me të drejtë janë udhëzuar palët për të drejtën në ankesë në aktvendimin e shkallës së parë) si dhe kategori kushtetuese, po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar sipas ankesës ka të drejtën dhe kompetencën që konform gjetjeve të ndryshoj (si në rastin konkret) vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Tutje lidhur pretendimet e shprehura në kërkesë të mbrojtjes, se “*PSRK-ja se mund të ushtroj mjetin juridik vetëm kundër ndërprerjes së masës së arrestit shtëpiak, me kërkesë ri-caktimin e arrestit shtëpiak, por assesi në emër të drejtës për ankesë kundër ndërprerjes së masës së arrestit shtëpiak të ushtronte në thelb kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit si masë më invazive*”, vlerëson se PSRK-ja, e pa kënaqur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin të akuzuarit E. S., e liron nga masa e arrestit shtëpiak për t’u mbrojtur në liri, fill pas shpalljes së aktgjykimit ku të akuzuarit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25 viteve, e njëjta me ankesë e atakon vendimin në fjalë, me propozim (siç rezulton nga përmbajtja e ankesës) që të akuzuarit Enver t’i caktohet-rikthehet masa për

sigurimin e të pandehurit në procedurë, por tani pas ndryshimit të rrethanave në procedurë, masa e paraburgimit si masë adekuate dhe më e sigurt për prezencën e të pandehurit në procedurë deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar, konform nenit 366, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe me paragrafin 6, propozim të cilin me të drejtë e miraton Gjykata e Apelit të Kosovës, e më pastaj vërtetohet edhe nga kolegji i (I) i Gjykatës Supreme. Për ndryshe po që se i akuzuari E. S., në momentin e shpalljes së aktgjykimit do të ishte duke u mbrojtur në liri, atëherë ankesa e PSRK-së me propozim për caktimin e paraburgimit si në rastin konkret do të kishte një kuptim tjetër.

Tutje kjo gjykatë vlerëson, se Gjykata e Apelit, drejtë ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, në vendimin e saj nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me peshën dhe mos përshtatshmërinë e mos vazhdimit të masës së arrestit shtëpiak duke e liruar të njëjtin që të mbrohet në liri pas shpalljes së aktgjykimit edhe se nuk ka vepruar drejtë kur ndaj të pandehurit është caktuar mbrojtja në liri, marr parasysh fakti se i pandehuri është akuzuar për veprë të rëndë penale dhe ku për të njëjtën veprë është shpallur fajtor dhe është dënuar me 25 vite burgim. Lartësia e dënimit të shqiptuar paraqet rrethana që e bënë të arsyeshëm drojën për rrezikun e arratisjes së të pandehurit.

Po ashtu, Gjykata Supreme të Kosovës, vlerëson se ende ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit nga nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, ndaj të akuzuarit në fjalë, duke pasur parasysh lartësinë e dënimit të shqiptuar, rrethanë kjo e cila tregon rrezikun se me lënien në liri të akuzuarit E. S., ekziston mundësia që i njëjti të pengoj rrjedhën e procedurës penale duke u arratisur, ikur apo fshehur për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, e në këtë mënyrë pamundësohet zhvillimi i rregullt i procedurës penale.

Andaj, duke pasur parasysh të cekurat si më lartë, kjo gjykatë vlerëson se masat tjera alternative, gjegjësisht mbajtja në liri e të akuzuarit do të ishte e pa mjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë penale dhe se pretendimet në kërkesë të mbrojtësit nuk janë të bazuara, caktimi i paraburgimit si masë e sigurisë për pranimin e të pandehurit në procedurë dhe përfundimin pa pengesë të saj, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.397/2024, më datë 01.07.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,  
Valdete Daka